


**PAUL WURTH ENERGY S.R.L. - Dega ne Shqiperi (ne likuidim)**

**Pasqyrat Financiare  
me dhe per periudhen e mbyllur me 31 dhjetor 2020**

Tedo Ibraković  


**PERMBAJTJA:**

**FAQE**

**PASQYRAT FINANCIARE**

<b>PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR</b>	<b>3</b>
<b>PASQYRA E PERFORMANCES FINANCIARE</b>	<b>4</b>
<b>PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO</b>	<b>5</b>
<b>PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE</b>	<b>6</b>
<b>SHENIME SHPJEGUESE TE PASQYRAVE FINANCIARE</b>	<b>7-13</b>



**PAUL WURTH ENERGY S.R.L. – Dega ne Shqiperi (ne likuidim)**  
**Pasqyra e Pozicionit Financiar me 31 dhjetor 2020**  
*(te gjitha shumat jane te shprehura ne Leke)*

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**

	<b>Shenime</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
<b>AKTIVET</b>			
<b>I. Aktivet afatshkurtra</b>			
Te drejta dhe te arketueshme tatimore	4	15,460	22,471,948
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra (I)</b>		<b>15,460</b>	<b>22,471,948</b>
<b>II. Aktivet afatgjata</b>			
<b>Totali i aktiveve afatgjata (II)</b>		-	-
<b>TOTALI I AKTIVEVE (I+II)</b>		<b>15,460</b>	<b>22,471,948</b>
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>			
<b>I. Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogari te pagueshme	5	388,913	382,845
Detyrime tatimore	6	7,254	8,054
Fonde te marra nga Shoqeria Meme	7	11,032,928	-
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)</b>		<b>11,429,095</b>	<b>390,899</b>
<b>II. Detyrimet afatgjata</b>			
Parapagime dhe te ardhura te shtyra	8	-	18,681,011
Fonde te marra nga Shoqeria Meme	7	-	8,158,227
<b>Totali i detyrimeve afatgjata (II)</b>		-	<b>26,839,238</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE (I+II)</b>		<b>11,429,095</b>	<b>27,230,137</b>
<b>III. Kapitali</b>			
Humbja e akumuluar		(4,758,189)	(2,279,845)
Humbja e vitit		(6,655,446)	(2,478,344)
<b>Totali i humbjes se vitit (III)</b>		<b>(11,413,635)</b>	<b>(4,758,189)</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)</b>		<b>15,460</b>	<b>22,471,948</b>

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 13, te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.

Keto Pasqyra Financiare u pergatiten nga Deloitte Albania sh.p.k. me NUIS J62329003N, perfaqesuar nga Znj.Violeta Perleka dhe u miratuan nga Likuidatori i Shoqerise PAUL WURTH ENERGY S.R.L. – Dega ne Shqiperi, me 31/12/2021.

Hartuesi  
**DELOITTE ALBANIA**  
 D.D. sh.p.k.  
 Rr. "Fak Konic", Nderesa N. 57, Nr. 1010 Tirane  
 Tel: +355 41 927 927 / Fax: +355 41 45 17990  
 N. 1000 N

Dega ne Shqiperi e Paul Wurth Energy s.r.l.  
 NUIS Likuidatori 309038A  
 Rr. "Elbasani", Postea Postale 10000, Postea e Re e Elbasanit, Elbasan  
 Gerhard Teli

Gerhard Teli

*(Signature)*

**PAUL WURTH ENERGY S.R.L. – Dega ne Shqiperi (ne lkkuidim)**  
**Pasqyra e Performances Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020**  
*(te gjitha shumat jane te shprehura ne Leke)*

**PASQYRA E PERFORMANCES FINANCIARE**

		Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
<b>I. Te ardhurat nga aktiviteti operativ</b>		-	-
<b>II. Shpenzime te aktivitetit operativ</b>			
Shpenzime personeli	9	(87,048)	(87,048)
Shpenzime operative	10	(6,954,088)	(2,168,339)
<b>Totali i shpenzimeve te aktivitetit operativ (II)</b>		<u>(7,041,136)</u>	<u>(2,255,387)</u>
<b>Humbja operative (I-II)</b>		<u>(7,041,136)</u>	<u>(2,255,387)</u>
<b>III. Fitim/(Humbja) financiare neto</b>			
Fitim/(Humbje) nga kembimet valutore		385,690	(222,957)
<b>Fitim/(Humbja) financiare neto (III)</b>	11	<u>385,690</u>	<u>(222,957)</u>
<b>Humbja para tatimit (I-II-III)</b>		(6,655,446)	(2,478,344)
Shpenzimi per tatimin mbi fitimin	12	-	-
<b>Humbja e vitit</b>		<u>(6,655,446)</u>	<u>(2,478,344)</u>
Te ardhura te tjera gjithepershireshe neto pas tatimit mbi fitimin		-	-
<b>Te ardhurat totale gjithepershireshe te vitit</b>		<u>(6,655,446)</u>	<u>(2,478,344)</u>

Pasqyra e Performances Financiare duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 13, te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.

**PAUL WURTH ENERGY S.R.L. – Dega ne Shqiperi (ne likuidim)**  
**Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020**  
*(te gjitha shumat jane te shprehura ne Leke)*

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO**

	<u>Humbje te mbartura</u>	<u>Kapitali total</u>
<b>Gjendja me 1 janar 2019</b>	<b>(2,279,845)</b>	<b>(2,279,845)</b>
Humbja e vitit	(2,478,344)	(2,478,344)
Te ardhura te tjera gjithepershires	-	-
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2019</b>	<b>(4,758,189)</b>	<b>(4,758,189)</b>
<b>Gjendja me 1 janar 2020</b>	<b>(4,758,189)</b>	<b>(4,758,189)</b>
Humbja e vitit	(6,655,446)	(6,655,446)
Te ardhura te tjera gjithepershires	-	-
<b>Gjendja me 31 dhjetor 2020</b>	<b>(11,413,635)</b>	<b>(11,413,635)</b>

Pasqyra e Ndryshimeve ne Kapitalin Neto duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 13, te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.



**PAUL WURTH ENERGY S.R.L. – Dega ne Shqiperi (ne likuidim)**  
**Pasqyra e Flukseve te Mjeteve Monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020**  
*(te gjitha shumat jane te shprehura ne Leke)*

**PASQYRA E FLUKSEVE TE MJETEVE MONETARE**

Shenime	Per vitin e	Per vitin e
	mbyllur me	mbyllur me
	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
<b>I. Mjete monetare gjeneruar nga (perdorur ne) veprimtari operative</b>		
<b>Humbja e vitit</b>	<b>(6,655,446)</b>	<b>(2,478,344)</b>
<i>Levizjet ne kapitalin punues:</i>		
Ndryshim ne te drejtat dhe te arketueshme tatimore	4 22,456,488	(256,348)
Ndryshim ne llogarite e pagueshme	5 6,068	(747,644)
Ndryshim ne detyrimet tatimore	6 (800)	(750,799)
Ndryshim ne fonde nga Shoqeria Meme	7 11,032,928	-
Ndryshim ne parapagime dhe te ardhura te shtyra	8 (18,681,011)	-
<b>Mjete monetare neto gjeneruar nga (perdorur ne) aktivitetet operative</b>	<b>8,158,227</b>	<b>(4,233,135)</b>
<b>II. Mjete monetare gjeneruar nga (perdorur ne) veprimtari investuese</b>		
<b>Mjete monetare neto gjeneruar nga (perdorur ne) veprimtari investuese</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>III. Mjete monetare gjeneruar nga (perdorur ne) veprimtaria financuese</b>		
Fonde shtese nga Shoqeria Meme	7 (8,158,227)	4,233,135
<b>Mjete monetare neto gjeneruar nga (perdorur ne) veprimtari financuese</b>	<b>(8,158,227)</b>	<b>4,233,135</b>
<b>Rritja/(pakesimi) neto ne mjete monetare dhe ekuivalente te tyre</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre ne 1 janar	-	-
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente te tyre me 31 dhjetor</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Pasqyra e Flukseve te Mjeteve Monetare duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 deri 13, te cilat jane pjese perberese e Pasqyrave Financiare.

**PAUL WURTH ENERGY S.R.L. – Dega ne Shqiperi (ne likuidim)**  
**Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020**  
*(te gjitha shumat jane te shprehura ne Leke, pervec se ku percaktohet ndryshe)*

## **1. INFORMACIONE TE PERGJITHSHME**

PAUL WURTH ENERGY S.R.L – Dega ne Shqiperi (referuar ketej e tutje si “PWEN” ose “Dega”) eshte dega e PAUL WURTH ENERGY S.R.L., themeluar ne Itali (referuar si “Shoqeria Meme”). Dega eshte regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, me 9 janar 2018, ne perputhje me Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, me numer unik identifikimi tatimor (NIPT) L81309038A.

Dega gjate vitit 2020 ka patur mesatarisht nje punonjes (perfaqesuesin e saj ligjor) te regjistruar ne listepagese (viti 2019: 1 punonjes).

Objekti i veprimtarise se Deges eshte transmetimi, projektimi, instalimi, gjencrimi, shperndarja dhe furnizimi me energji elektrike, trajtimi i mbeturinave dhe biomases, konvertimi i tyre ne produkte te vlefshme dhe gjenerimi i energjise elektrike dhe/ose ngrohjes, duke perfshire kogjenerimin ne baze te karburanteve konvencionale. Dega gjithashtu, eshte e fokusuar ne sigurimin e mbeshtetjes per mirembajtjen e impianteve industriale dhe civile.

Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 jane pergatitur ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit te permiresuara (SKK) dhe Ligjin nr. 25/2018 date 10.05.2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

## **2. BAZAT E PERGATITJES**

### **2.1 Deklarata e perputhshmerise**

Keto pasqyra financiare jane pergatitur ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi te publikuara nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit ne Shqiperi dhe te permiresuara me efekt nga 1 janar 2015.

### **2.2 Parimi i vijimesise**

Deri me 31 dhjetor 2020, Dega ka humbje te akumuluar ne vleren 11,413,636 leke. Viti 2020 eshte viti i trete i themelimit te Deges ne Republiken e Shqiperise, gjate te cilit Dega nuk ka zhvilluar aktivitet. Gjate kesaj faze, Dega eshte mbeshtetur me financime nga Shoqeria Meme per permbushjen e nevojave per likuiditet.

Megjithate, per arsye te ndryshme manaxheriale, Drejtimi vlereson se Dega nuk do te jete ne gjendje te vazhdoje aktivitetin sipas parimit te vijimesise pasi ka si qellim cregjistrimin e saj sipas procedures se likuidimit vullnetar. Drejtimi ka vendosur fillimin e procedurave te likuidimit me date 07.01.2021, perpara pergatitjes dhe aprovimit te ketyre pasqyrave financiare, duke caktuar si likuiduesin e saj Z.Gerhard Teli.

### **2.3 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

### **2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Leke, e cila eshte njekohesisht dhe monedha funksionale e Deges.



## **2. BAZAT E PERGATTJES (VAZHDIM)**

### **2.5 Perdorimi i vleresimeve dhe gjykimeve**

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit e Deges te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te Deges dhe ne raportimin e te gjithe vlerave te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje nga keto vleresime. Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel njihen ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar, si dhe ne periudhat e ardhme qe preken.

Informacioni mbi fushat me te rendesishme te vleresimeve, pasigurise dhe gjykimeve kritike ne zbatimin e politikave kontabel ne keto pasqyra financiare eshte perfshire ne shenimet vijuese. Perdorimi i vleresimeve kontabel eshte minimal ne pasqyrat financiare aktuale, duke marre parasysh thjeshtesine e kontabilitetit te pershtatshem per natyren e veprimeve qe kryen Dega.

## **3. POLITIKA KONTABEL TE RENDESISHME**

Politikat kontabel te meposhtme jane zbatuar per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 sic paraqiten ne keto pasqyra financiare.

### **3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj**

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e raportimit. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit, ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlere e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit njihen pergjithesisht ne fitime ose humbje.

Kursi i kembimit ne fund te periudhes se raportimit dhe periudhes parardhese te raportimit jane si vijon:

<b>Kurset e kembimit</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>
ALL/EUR	123.70	121.77

### **3.2 Instrumenta financiare**

Instrumentat financiare jo-derivative perbehen nga te drejta te arketueshme, llogari te pagueshme, te pagueshme ndaj punonjesve, ndaj autoriteteve tatimore dhe ndaj Shoqerise Meme. Te gjitha aktivitetet dhe detyrimet financiare njihen fillimisht me vleren e drejte plus çdo kosto transaksioni qe lidhet me to. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiare jo-derivative njihen siç pershkruhet me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese Dega behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te Deges mbi flukset e parase se aktiviteti financiar ose kur Dega transferon aktivitetin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithe risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen Dega angazhohet te bleje apo te shese



### **3. POLITIKA KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)**

#### **3.2 Instrumenta financiare (vazhdim)**

aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te Deges skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

#### *Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre*

Dega nuk ka mjete monetare dhe ekuivalente te tyre me 31 dhjetor 2020.

#### *Te drejta te arketueshme*

Te drejtat e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provigjioni per zhvleresimin e te drejtave te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se Dega nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe te drejtat e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provizionit llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve monetare te ardhshme te skontuara me normen e interesit efektiv.

#### *Llogarite e pagueshme, detyrimet tatimore dhe fondet nga Shoqeria Meme*

Llogarite e pagueshme, detyrimet tatimore, fondet nga Shoqeria Meme paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me koston e amortizuar duke perdorur metoden e interesit efektiv.

#### *Vlera e drejte*

Vlera e drejte e vleresuar per mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, te drejtat e arketueshme, llogarite e pagueshme, detyrimet tatimore, fondet nga Shoqeria Meme, i perafrohen vleres se tyre kontabel.

#### *Zhvleresimi*

Nje aktiv financiar rivleresohet ne çdo date raportimi per te percaktuar nese ekzistojne evidenca objektive qe vertetojne zhvleresimin e tij. Aktivet financiare zhvleresohen kur ekzistojne prova qe vlera e ardhshme e flukseve te parase qe gjeneron aktivi jane ndikuar. Per aktivet financiare te mbajtur me kosto te amortizuar, shuma e zhvleresimit eshte diferenca midis vleres se mbetur te aktivitetit dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parase te skontuar me normen efektive fillestare te interesit te aktivitetit financiar.

Aktivitetet financiare, te cilat individualisht kane nje peshe te ndjeshme testohen per zhvleresim ne baza individuale. Pjesa e mbetur e aktiveve financiare vleresohen te grupuar ne kategori qe kane karakteristika te perbashketa risku. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne rezultatin e periudhes.

#### **3.3 Provizionet**

Nje provizion njihet nese, si rezultat i ngjarjeve te meparshme, Dega ka nje detyrim ligjor ose konstruktiv, i cili mund te vleresohet me besueshmeri dhe do te kerkoje flukse dalese monetare te ardhshme per shlyerjen e tij. Provizionet percaktohen duke skontuar flukset monetare te ardhshme te pritshme me nje norme skontimi para tatimit, e cila reflekton vleresimin aktual te tregut per vleren ne



### **3. POLITIKA KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)**

#### **3.3 Provizionet (vazhdim)**

kohe te parase dhe rreziqet qe lidhen me detyrimin ne fjale. Dega nuk ka njohur provision me 31 dhjetor 2020.

#### **3.4 Njohja e te ardhurave**

Te ardhurat njihen kur eshte e mundshme qe perfitimet ekonomike te lidhura me to do te vijne ne favor te Deges dhe kur vlera e tyre mund te matet ne menyre te besueshme. Te ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur rreziqet dhe perfitimet thelbesore te lidhura me pronesine transferohen nga shitesi te bleresi. Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve njihen duke iu referuar fazes se perfundimit te transakcionit ne daten e raportimit. Dega nuk ka te ardhura te gjeneruara vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020.

#### **3.5 Te ardhura dhe shpenzime financiare**

Te ardhurat financiare perfshijne fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne fitime ose humbje. Shpenzimet financiare perfshijne humbjet nga kursi i kembimit.

Te ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e interesit njihen mbi bazen e te drejtave te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv.

#### **3.6 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyre. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtperdrejte ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i vitit eshte tatimi i pritshem per t'u paguar mbi te ardhurat e tatueshme te vitit, duke perdorur normat tatimore te miratuara gjate vitit. Norma e tatimit mbi fitimin eshte 15% e fitimit te tatueshem. Per periudhen raportuese, Dega ka rezultuar me humbje fiskale, prandaj nuk kemi shpenzime per tatimin mbi fitimin. Dega nuk ka njohur tatim te shtyre, duke qene se nuk ka identifikuar diferenca te perkohshme midis vleres kontabel dhe bazes se taksueshme te aktiveve/detyrimeve te saj.

### **4. TE DREJTA DHE TE ARKETUESHME TATIMORE**

Te drejtat e arketueshme me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 jane te perbera si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
<i>Te arketueshme tatimore:</i>		
Te arketueshme te tjera	15,460	11,921
TVSH e kreditueshme	-	541,427
<i>Te arketueshme nga aktiviteti operativ</i>		
Integrated Technology Waste Treatment Fier sh.p.k.	-	21,918,600
<b>Totali</b>	<u>15,460</u>	<u>22,471,948</u>

**PAUL WURTH ENERGY S.R.L. – Dega ne Shqiperi (ne likuidim)**  
**Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020**  
*(te gjitha shumet jane te shprehura ne Leke, pervec se ku percaktohet ndryshe)*

**5. LLOGARI TE PAGUESHME**

Llogarite e pagueshme me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Deloitte Albania sh.p.k.	388,913	382,845
<b>Totali</b>	<u>388,913</u>	<u>382,845</u>

**6. DETYRIME TATIMORE**

Detyrimet tatimore me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	7,254	8,054
<b>Totali</b>	<u>7,254</u>	<u>8,054</u>

Detyrimet tatimore ne shumen 7,254 leke per vitin e perfunduar me 31 dhjetor 2020, i referohen detyrimeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore mbetur te paguara per muajin dhjetor 2020, te paguara ne muajin janar 2021.

**7. FONDE TE MARRA NGA SHOQERIA MEME**

Fonde te marra nga Shoqeria Meme per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 perbehen si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Te pagueshme ndaj Shoqerise Meme	11,032,928	8,158,227
<b>Totali</b>	<u>11,032,928</u>	<u>8,158,227</u>

Duke qene se Dega nuk permbush me parimin e vijimesise, detyrimet afatgjata te Deges me 31.12.2019 jane riklasifikuar dhe jane paraqitur si detyrime afatshkurtra per vitin e mbyllur me 31.12.2020.

**8. PARAPAGIME DHE TE ARDHURA TE SHTYRA**

Parapagimet dhe te ardhurat e shtyra me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Parapagime te marra sipas kontrates	-	18,681,011
<b>Totali</b>	<u>-</u>	<u>18,681,011</u>

Parapagimet dhe te ardhurat e shtyra per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 mbeten ne shumen zero Leke. Parapagimet e faturuara ndaj klientit kryesor ne baze te kontrates nr. 17C043, neni 5 "Kushtet e Pageses" të lidhur ndermjet Deges dhe Integrated Technology Waste Treatment Fier sh.p.k., jane anuluar plotesisht nepermjet notave te kreditit te leshuara ne muajin dhjetor 2020.

**PAUL WURTH ENERGY S.R.L. – Dega ne Shqiperi (ne likuidim)**  
**Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020**  
*(te gjitha shumat jane te shprehura ne Leke, pervec se ku percaktohet ndryshe)*

**9. SHPENZIME PERSONELI**

Shpenzimet e personelit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 perbehen nga sa me poshte:

	<b>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020</b>	<b>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019</b>
Kontribute te sigurimeve shoqerore e shendetsore	87,048	87,048
<b>Totali</b>	<b>87,048</b>	<b>87,048</b>

Dega ka perlogaritur, deklaruar, dhe paguar kontribute te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore ne perputhje me Ligjin nr. 9136, date 11.09.2003 “Per mbledhjen e detyrueshme te kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore”, si dhe Udhezimit perkates nr. 26, date 16.04.2009, per perfaqesuesin e saj ligjor.

**10. SHPENZIME OPERATIVE**

Shpenzimet operative per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 perbehen nga sa me poshte:

	<b>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020</b>	<b>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019</b>
Rregullime te balances se TVSH-se kreditore	4,688,377	-
Sherbime kontabiliteti	1,801,761	1,709,271
Sherbime sekretarie	444,846	443,199
Taksa dhe tarifa vendore	13,750	12,500
Shpenzime te tjera	5,215	1,481
Gjoha dhe demshperblime	139	88
Shpenzime per sherbimet bankare	-	1,800
<b>Totali</b>	<b>6,954,088</b>	<b>2,168,339</b>



**PAUL WURTH ENERGY S.R.L. – Dega ne Shqiperi (ne likuidim)**  
**Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020**  
*(te gjitha shumat jane te shprehura ne Leke, pervec se ku percaktohet ndryshe)*

**11. FITIM/(HUMBJA) FINANCIARE NETO**

Fitim/(Humbja) financiare neto per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 2019 analizohet si me poshte:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
<b>Te ardhura financiare</b>		
Fitim nga kursi i kembimit	459,703	81,815
	<u>459,703</u>	<u>81,815</u>
<b>Shpenzime financiare</b>		
Humbje nga kursi i kembimit	(74,013)	(304,772)
	<u>(74,013)</u>	<u>(304,772)</u>
<b>Fitim/(Humbja) financiare neto</b>	<u>385,690</u>	<u>(222,957)</u>

**12. SHPENZIMI PER TATIMIN MBI FITIMIN**

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 perbehet nga sa me poshte:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
Humbja para tatimit	(6,655,446)	(2,478,344)
Shpenzime te panjohura	4,723,460	35,032
<b>Humbja e tatueshme e vitit</b>	<u>(1,931,986)</u>	<u>(2,443,312)</u>
Humbje fiskale te mbartura nga vitet e kaluara	(4,680,267)	(2,236,955)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin (15%)	-	-
Tatim fitimi i parapaguar	-	-
<b>Tatim fitimi per t'u paguar</b>	<u>-</u>	<u>-</u>

**13. NGJARJET PAS DATES SE RAPORTIMIT**

Nuk kane ndodhur ngjarje te tjera te rendesishme pas dates se raportimit, te cilat kane nevojte per rregullim apo paraqitje ne keto pasqyra financiare.

Tedi Hoxhoni  
